

31991R3922

Rregullore e Këshillit (KEE) nr. 3922/91 datë 16 dhjetor 1991 mbi harmonizimin e kërkesave teknike dhe procedurave administrative në fushën e aviacionit civil

Gazeta Zyrtare L 373 më 31/12/1991 fq. 0004 – 0008

Botimi i veçantë finlandez: Kapitulli 7, Vëllimi 4 fq. 0052

Botimi i veçantë suedez: Kapitulli 7, Vëllimi 4 fq. 0052

Rregullore e Këshillit (KEE) nr. 3922/91 datë 16 dhjetor 1991, mbi harmonizimin e kërkesave teknike dhe procedurave administrative në fushën e aviacionit civil .

Këshilli i Komuniteteve Europiane,

Duke pasur parasysh Traktatin Themelues të Komunitetit Ekonomik Europian dhe veçanërisht nenin 84 pika 2 të tij,

Duke pasur parasysh propozimin e Komisionit [1],

Duke pasur parasysh mendimin e Parlamentit Europian [2],

Duke pasur parasysh mendimin e Komitetit Ekonomik dhe Social [3],

Duke pasur parasysh se, sikurse parashikohet në nenin 8a të Traktatit duhet të miratohen masa , me qëllim themelimin në mënyrë progresive të tregut të brendshëm, brenda një periudhe që përfundon, më 31 dhjetor 1992; duke pasur parasysh se tregu i brendshëm do të përbëhet nga një zonë pa kufij të brendshëm në të cilën duhet të sigurohet lëvizja e lirë e mallrave, personave, shërbimeve dhe kapitalit,

Duke pasur parasysh senë Europë duhet të ruhet nivel i lartë i sigurisë në aviacionin civil dhe se kërkesat teknike e procedurat administrative aktuale në Shtetet Anëtare, duhet të ngrihen në standardin më të lartë që është arritur tashmë në Komunitet,

Duke pasur parasysh se siguria është një faktor kryesor në transportin ajror komunitar, duke pasur parasysh se duhet të merret në konsideratë Konventa mbi Aviacionin Civil Ndërkombëtar e nënshkruar në Çikago, më 7 dhjetor 1944, që parashikon zbatimin e masave të nevojshme për të siguruar funksionimin e sigurt të avionit;

Duke pasur parasysh se kufizimet e tashme për transferimin e avionëve dhe produkteve të aviacionit dhe të shërbimeve të ndryshme në fushën e aviacionit ndërmjet Shteteve Anëtare , do të shkaktonin deformime në tregun e brendshëm,

Duke pasur parasysh se Autoritetet e Përbashkëta të Aviacionit (APA), një organ partner i Konferencës Europiane të Aviacionit Civil (KEAC), kanë përgatitur masat për të bashkëpunuar në zhvillimin dhe zbatimin e kërkesave të përbashkëta të aviacionit (KPA-ve) në fushat, që kanë të bëjnë me sigurinë e avionëve dhe funksionimin e tyre,

Duke pasur parasysh se, sipas politikës së përbashkët të transportit, duhet të harmonizohen kërkesat teknike dhe procedurat administrative në lidhje me sigurinë e avionëve dhe funksionimin e tyre mbi bazën e kodeve të KPA-it të APA-së,

Duke pasur parasysh se, anëtarësimi i të gjithë Shteteve Anëtare në APA dhe pjesëmarrja e Komisionit në procedurat e saj do të lehtësonte këtë harmonizim,

Duke pasur parasysh se me qëllim arritjen e objektivave të Komunitetit në lidhje me lirinë e lëvizjes së personave dhe produkteve, dhe gjithashtu në lidhje me politikën e përbashkët të transportit, Shtetet Anëtare duhet të pranohet të certifikimin e produkteve, organeve dhe personave të përfshirë në projektimin, prodhimin, mirëmbajtjen dhe përdorimin e produkteve pa punë ose vlerësim tjetër teknik, kur produkti, organizata ose personi është certifikuar në përputhje me kërkesat teknike dhe procedurat e përbashkëta administrative,

Duke pasur parasysh se, problemet e sigurisë mund të lindin dhe, në një rast të tillë, Shtetet Anëtare duhet të marrin të gjitha masat e përshtatshme si çështje urgjente: duke pasur parasysh se këto masa duhet të justifikohen si duhet dhe nëse kërkesat teknike, dhe procedurat e përbashkëta administrative paraqesin mangësi, i takon Komisionit, në ushtrim të kompetencave të tij ekzekutive, të miratojë ndryshimet e nevojshme:

Duke pasur parasysh se është e pranueshme, që financimi nga Shtetet Anëtare për kërkimet për përmirësimin e sigurisë së aviacionit të bashkërendohet për të siguruar një përdorim sa më të përshtatshëm të burimeve dhe për të siguruar arritjen e një përfitimi maksimal,

Duke pasur parasysh se është e përshtatshme, që t'i jepen kompetenca Komisionit të mbështetur nga komiteti i ekspertëve të emëruar nga Shtetet Anëtare, të bëjnë ndryshimet e zhvilluara nga JAA-ri për kërkesat teknike dhe procedurat e përbashkëta administrative të miratuara nga Këshilli,

KA MIRATUAR KËTË RREGULLORE:

Neni 1

1. Kjo rregullore zbatohet për harmonizimin e kërkesave teknike dhe procedurave administrative në fushën e sigurisë së aviacionit civil të renditur në Shtojcën II, dhe veçanërisht në lidhje me:

- projektimin, prodhimin, përdorimin dhe mirëmbajtjen e avionëve;
- personat dhe organizatat e përfshira në këto detyra.

2. Kërkesat teknike dhe procedurat administrative të harmonizuara të përmendura në paragrafin 1, zbatohen për të gjithë avionët e përdorur nga përdoruesit sikurse parashikohet në nenin 2 pika (a), i regjistruar në një Shtet Anëtar, ose në një vend të tretë.

Neni 2

1. Për qëllimin e kësaj rregulloreje:

(a) “përdorues” nënkupton një person fizik me banim në një Shtet Anëtar ose një person juridik i themeluar në një Shtet Anëtar, që përdor një ose më shumë avionë në përputhje me rregulloret e zbatueshme në atë Shtet Anëtar, ose një transportues ajror komunitar sipas përkufizimit në legjislacionin komunitar;

(b) “produkt” nënkupton një avion civil, motor, helikë, ose pajisje;

(c) “pajisje” nënkupton një instrument, pajisje, mekanizëm, aparat ose aksesor i përdorur ose që nevojitet të përdoret në funksionimin e një avioni në fluturim, qoftë i montuar, i cili nevojitet të montohet ose bashkohet me një avion civil, por që nuk është pjesë e strukturës, motorit ose helikës;

(d) “përbërës” nënkupton një material, pjesë ose pjesë dytësore, që nuk përfshihet nga përkufizimet në pikën (b) ose (c) për përdorim në avionët civilë, motorë, helika ose pajisje;

(e) “certifikim” (i një produkti, shërbimi, organizate ose personi) nënkupton një formë e njohjes ligjore, ku një produkt, shërbim, organ ose person i tillë i përmbush kërkesat e zbatueshme. Ky certifikim përbëhet nga dy akte:

- (i) akti i kontrollit që, teknikisht produkti, shërbimi, organizata ose personi përmbush kërkesat e zbatueshme ; ky akt quhet “kryerja e konstatimeve teknike”;

(ii) akti i njohjes formale i kësaj përputhjeje me kërkesat e zbatueshme nëpërmjet lëshimit të një certifikate, licence, miratimi ose dokumenti tjetër në mënyrën e kërkuar nga ligjet kombëtare dhe procedurat; ky akt quhet si “kryerja e konstatimeve ligjore”

(f) “mirëmbajtje” nënkupton të gjitha inspektimet, shërbimet, ndryshimet dhe riparimet gjatë gjithë jetëgjatësisë së një avioni , që nevojiten për të siguruar që avioni të mbetet në përputhje me tipin e certifikimit dhe të ofrojë një nivel të lartë sigurie në të gjitha rrethanat; kjo do të përfshinte veçanërisht modifikimet e vendosura nga autoritetet palë në masat e përmendura në germën (h) , në përputhje me konceptet e kontrollit të përshtatshmërisë për fluturim;

(g) “variant i brendshëm” nënkupton një kërkesë ose rregullore e brendshme e caktuar nga një vend, si shtesë ose në vend të një KPA-e;

(h) “masa” nënkupton masat e zhvilluara nën kujdesin e Konferencës Europiane për Aviacionin Civil (KEAC), për bashkëpunim në zhvillimin dhe zbatimin e kërkesave të përbashkëta në të gjitha fushat, në lidhje me sigurinë dhe funksionimin e sigurt të avionëve. Këto masa përcaktohen në Shtojcën I.

Neni 3

Pa cenuar nenin 11, kërkesat teknike dhe procedurat administrative të përbashkëta, që zbatohen në Komunitet në lidhje me fushat e renditura në Shtojcën II, janë kodet përkatëse të përmendura në atë shtojcë dhe kanë hyrë në fuqi, më 1 janar 1992.

Neni 4

1. Në lidhje me fushat që nuk janë renditur në Shtojcën II, Këshilli miraton kërkesat teknike dhe procedurat administrative të përbashkëta, bazuar në nenin 84 pika (2) të Traktatit. Komisioni, sipas rastit dhe sapo të jetë e mundur, paraqet propozime të përshtatshme në këto fusha.

2. Në pritje të miratimit të propozimeve të përmendura në paragrafin 1, Shtetet Anëtare mund të zbatojnë dispozitat përkatëse të rregulloreve të brendshme të tyre ekzistuese.

Neni 5

Shtetet Anëtare sigurojnë që autoritetet e tyre përgjegjëse të aviacionit civil , të përmbushin kushtet për anëtarësimin në JAA të përcaktuara në masat, dhe i nënshkruajnë këto masa pa ndonjë rezervë, para 1 janarit 1992.

Neni 6

1. Shtetet Anëtare, pa kërkesa ose vlerësim tjetër teknik, njohin produktet e projektuara, prodhuara, përdorura dhe mirëmbajtura në përputhje me kërkesat teknike dhe procedurat e përbashkëta administrative ,nëse këto produkte janë certifikuar nga një Shtet tjetër Anëtar. Kur njohja origjinale është për një qëllim ose disa qëllime të caktuara, çdo njohje pasuese mbulon të njëjtin ose të njëjtat qëllime.

2. Produktet ekzistuese dhe nënproduktet e tyre , që nuk janë certifikuar në përputhje me kërkesat teknike dhe procedurat administrative të përbashkëta, mund të pranohen nga një Shtet Anëtar në bazë të rregulloreve të brendshme të tanishme, në pritje të kërkesave teknike dhe procedurave të përbashkëta administrative të zbatueshme për këto produkte në përputhje me këtë rregullore.

Neni 7

Shtetet Anëtare njohin certifikimin e dhënë në përputhje me këtë rregullore nga një Shtet tjetër Anëtar ose nga një organ, i cili vepron në emër të tij për organet ose personat që janë nën juridiksionin dhe nën autoritetin e tij, të cilët janë përfshirë në projektimin, prodhimin, mirëmbajtjen e produkteve dhe përdorimin e avionit.

Neni 8

1. Asnjë nga dispozitat e mësipërme nuk e pengon një Shtet Anëtar të veprojë menjëherë në lidhje me një problem sigurie që shfaqet gjatë një aksidenti, ngjarjeje ose përvoje shërbimi dhe që ka të bëjë me një produkt të dezinjuar, prodhuar, përdorur ose mirëmbajtur në përputhje me këtë rregullore, ose me një person, procedurë ose organ të përfshirë në këto detyra. Nëse problemi i sigurisë rrjedh nga:

- një nivel i pamjaftueshëm sigurie që përputhet me zbatimin e kërkesave teknike dhe procedurave të përbashkëta administrative, ose;
- mangësi në kërkesat teknike dhe procedurat e përbashkëta administrative,

Shteti Anëtar njofton menjëherë Komisionin dhe Shtetet e tjera Anëtare për masat e marra dhe arsyet për to.

2. Në rastet e përmendura në paragrafin 1, Komisioni këshillohet me Shtetet Anëtare në mundësinë më të parë. Nëse konfirmohet një nivel i pamjaftueshëm sigurie ose mangësi në kërkesat e përbashkëta teknike dhe në procedurat administrative, Komisioni bën të gjitha propozimet e përshtatshme në përputhje me procedurat e parashikuara në nenin 4 dhe/ose nenin 11.

Neni 9

Shtetet Anëtare marrin të gjitha masat e nevojshme për të bashkërenduar programet e tyre të kërkimit, për të përmirësuar sigurinë e avionëve civilë dhe përdorimin e tyre dhe për të njoftuar për këtë, Komisionin. Pas këshillimit të Shteteve Anëtare, Komisioni mund të ndërmarrë çdo nismë të përshtatshme për të nxitur programe të tilla kombëtare kërkimi.

Neni 10

Shtetet Anëtare njoftojnë Komisionin për:

- (a) çdo kërkesë ose procedurë të re ose të ndryshuar, të zhvilluar ose miratuar në përputhje me procedurat e parashikuara në masat dhe;
- (b) çdo ndryshim të rregullimeve dhe;
- (c) përfundimet e këshillimeve me organet e industrisë dhe të interesuarve.

Neni 11

1. Komisioni, sipas procedurës së parashikuar në nenin 12, bën të gjitha ndryshimet, të cilat i nevojiten progresit shkencor e teknik, në kërkesat teknike dhe procedurat e përbashkëta administrative të renditura në Shtojcën II ose të miratuara nga Këshilli në përputhje me nenin 4.

2. Kur ndryshimet e përmendura në paragrafin 1 përmbajnë një variant të brendshëm për një Shtet Anëtar, Komisioni, sipas procedurës së parashikuar në nenin 12, vendos nëse do ta përfshijë ose jo atë variant në kërkesat teknike dhe procedurat e përbashkëta administrative.

Neni 12

1. Për zbatimin e neneve 8, 9 dhe 11, Komisioni mbështetet nga një komitet i përbërë nga përfaqësues të Shteteve Anëtare dhe kryesohet nga përfaqësuesi i Komisionit.

2. Përfaqësuesi i Komisionit i paraqet komitetit një projekt për masat që duhet të merren. Komiteti paraqet mendimin e tij për projektin brenda një afati kohor të mundshëm, për t'u caktuar nga kryetari në përputhje me urgjencën e çështjes. Mendimi jepet nga shumica e parashikuar sipas nenit 148 pika (2) të Traktatit, për rastin e vendimeve që Këshillit i kërkohet miratim ndaj një propozimi të Komisionit. Vota e përfaqësuesit të Shteteve Anëtare brenda komitetit vlerësohet në mënyrën e parashikuar, po në atë nen. Kryetari nuk voton.

3. (a) Komisioni miraton masat e parashikuara nëse ato janë në përputhje me mendimin e komitetit.
(b) Nëse masat e parashikuara nuk janë në përputhje me mendimin e komitetit, ose nëse nuk është dhënë mendim, Komisioni, pa vonesë, i paraqet Këshillit një propozim në lidhje me masat që duhen marrë. Këshilli vepron me shumicë të cilësuar.
(c) Nëse me kalimin e një afati kohor prej tre muajsh nga data e referimit në Këshill, Këshilli nuk ka vepruar, masat e propozuara miratohen nga Komisioni përveçse, kur Këshilli ka vendosur kundër këtyre masave me një shumicë të thjeshtë.

Neni 13

1. Shtetet Anëtare mbështesin njëri-tjetrin në zbatimin e kësaj rregulloreje dhe në vëzhgimin e zbatimit të saj.
2. Si pjesë e mbështetjes së ndërsjellë të referuar në paragrafin 1, autoritetet kompetente të Shteteve Anëtare shkëmbejnë rregullisht informacion për:
- shkeljet e kësaj rregulloreje nga jobanuesit dhe gjobat e vendosura për këtë;
 - gjobat e vëna banuesëve të vet nga një Shtet Anëtar në lidhje me këto shkelje, të kryera në Shtete të tjera Anëtare.

Neni 14

Kjo rregullore hyn në fuqi, më 1 janar 1992.

Kjo rregullore është detyruese në tërësinë e saj dhe drejtpërdrejt e zbatueshme në të gjithë Shtetet Anëtare.

Nënshkruar në Bruksel, më 16 dhjetor 1991.

Për Këshillin,

Presidenti

Maij – Weggen

[1] GZ nr. C 270, 26.10.1990, fq. 3,

[2] GZ nr. C 267, 14.10.1991, fq. 154,

[3] GZ nr. C 159 16.06.1991, fq. 28.

SHTOJCA I

Masat e përmendura në nenin 2 pika 1 germa (h).

“Masat në lidhje me zhvillimin, pranimin dhe zbatimin e kërkesave të përbashkëta të aviacionit (KPA),” të përfunduar në Qipro, më 11 shtator 1990.

SHTOJCA II

Lista e kodeve në fuqi që përmbajnë kërkesat teknike dhe procedurat e përbashkëta administrative të përmendura në nenin 3.

1. Të përgjithshme dhe procedura

KPA 1. Përkufizime dhe shkurtime

2. Certifikimi për llojin e produkteve dhe pjesëve

KPA 22 .Planerët dhe planerët me motorë

JARKPA 25, Aeroplanë të mëdhenj

KPA AWO Operacione në çdo lloj moti

KPA E, Motorë

KPA P, Helika

KPA APU, Njësi fuqie shtesë

KPA TSO, Urdhrat teknike standarde

KPA VLA, Aeroplanë shumë të lehtë

KPA 145, Organizatat e miratuara për mirëmbajtje.